Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçienca e Energjisë

Praktikat, mundësitë, veprimet

KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, KOSOVË, 20 – 21 TETOR 2008

REZULTATET DHE REKOMANDIMET



"Në Kosovën e re, me energji të pastër dhe mjedis të shëndetshëm"

Mbështetur nga: gtz Partner für die Future Worldwide · ProCredit Bank · STRABAG

Parathënie

Të nderuar lexues,

Kemi nderin dhe kënaqësinë t'i ndajmë bashkë me Ju, rezultatet kyçe të konferencës "Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçienca e Energjisë-Praktikat, Mundësitë, Veprimet", të mbajtur në Prishtinë me 20 dhe 21 tetor 2008. Rezultatet e prezantuara në këtë publikim janë vetëm një përmbledhje e shkurtër e punimeve të konferencës, prezantimeve, rekomandimeve dhe projekteve të identifikuara.

Konferenca "Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçienca e Energjisë- Praktikat, Mundësitë, Veprimet", u organizua nën patronatin e Ministrit të MMPH-së, z. Mahir Yagcilar, në saje të punës dhe angazhimit të pamohueshëm të stafit të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Energjisë dhe Minierave, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Institutin Kombëtarë të Shëndetin Publik të Kosovës dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Organizimi i konferencës u mundësua në saje të mbështetjes së pa rezervë nga GTZ-ja dhe Ministria Federale Gjermane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, si dhe nga sponsorët tjerë si ProCredit Bank dhe Strabag, të cilëve u shprehim falënderimin tonë të sinqertë për këtë mbështetje.



Komiteti drejtues i Konferencës

Ilir Morina, AKMM
Grabiele Becker, GTZ
Kadri Hyseini, MMPH
Gunaj Hallaç, MMPH
Samet Dalipi, MAPL
Naser Ramadani, IKSHPK
Skënder Nitaj, MEM
Florina Jerliu, UP
Muhamet Malsiu, MMPH
Sazan Ibrahimi, AKK

Përgatitja e materialeve dhe koordinimi i aktiviteteve

Rizah Hajdari, AKMM
Nexhat Jashari, GTZ
Afrim Berisha, AKMM
Tomor Qelaj– AKMM
Driton Vatovci-GTZ
Lule Isufi, AKMM
Bajram Kafexholli-AKMM

Udhëheqja e sesioneve dhe grupeve punuese

Sesioni Tematik A
(Skënder Nitaj & Gabriele Becker)

Korniza ligjore
(Driton Vatovci & Samet Dalipi)
Korniza institucionale
(Lulëzim Korenica & Besim Kamberaj)
Financat dhe masat stimuluese
(Bajram Bujupi & Osman Sadikaj)

Sesioni tematik B
(Nexhat Jashari & Liulin Radulov)

Projektet për ngritjen e kapaciteteve
(Burbuqe Nushi & Sabit Restelica)
Projektet për vetëdijesim dhe sensibilizim
(Zeqir Veselaj & Bajram Kadriu)
Projektet konkrete teknike
(Maliq Pireci & Naim Ismajli)

Preambula

Qëllimi i konferencës

Nëpërmjet veprimeve të përbashkëta të identifikoj praktikat, mundësitë dhe mekanizmat për zbatimin e efiçiencës së energjisë nëpër komuna në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik.

Në konferencë janë diskutuar çështje si:

- Fuqizimi i koordinimit dhe bashkëpunimit në mes të palëve/faktorëve relevant dhe në mes të dy niveleve të qeverisjes;
- Involvimi i shoqërisë civile dhe sektorit privat në aktivitete mjedisore dhe të efiçiencës së energjisë;
- Mjedisi dhe shëndeti publik – ndërlidhja në mes tyre;
- Parakushtet ligjore dhe institucionale për zbatimin e suksesshëm të efiçiencës së energjisë në nivel lokal;
- Roli dhe përgjegjësitë e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me çështjet mjedisore;
- Fuqizimi dhe shfrytëzimi i funksionimit të rrjeteve ekzistuese lidhur me efiçiencën e energjisë dhe mjedisin;
- Nevojën për ngritjen e kapaciteteve;
- Vendosja e bazave të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve nga institucionet përgjegjëse për efiçiencën e energjisë në nivel kombëtar dhe lokal dhe
- Bashkëpunimi regjional, ndërkombëtar dhe këmbimi i përvojave.

Si rezultat i punës nëpër sesione tematike dhe në grupe punuese konferenca ka identifikuar:

- Nevojat për plotësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për zbatimin e efiçiencës së energjisë në nivelin lokal;
- Mekanizmat për zbatimin e efiçiencës së energjisë në nivelin lokal,
- Nevojat për ngritje të kapaciteteve,
- Projektet për sensibilizimin e opinionit dhe
- Projektet tjera praktike për efiçiencë të energjisë.

Pjesëmarrësit:

Në konferencë kanë marrë pjesë mbi 200 pjesëmarrës nga institucione të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare të Kosovës, si dhe dhjetëra ekspertë ndërkombëtarë nga vendet e ndryshme të rajonit dhe me gjerë.

Moto e konferencës "Në Kosovën e re, me energji të pastër dhe mjedis të shëndetshëm"



Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçenca e Energjisë

Shtytja kryesore për organizimin e konferencës nga AKMM ishte qe sektori i energjetikes i identifikuar si sektori më me ndikim ne çështjen mjedisore, te trajtohet ne diskutime dhe punëtori te konferencës dhe në ketë mënyre të kërkohen mundësi për t'i kontribuar zbutjes së probleme mjedisore dhe energjetike.

Energjetika luan rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në jetën e modernizuar të njeriut. Por, edhe ndikimet e saj në mjedis janë mjaft te theksuara. Çfarëdo qoftë mënyre e prodhimit të energjisë ka ndikim të ndjeshëm në mjedis, për shkak të operacioneve që e përcjellin që nga sigurimi i lendes së parë dhe transportit të saj e deri te procesi i prodhimit dhe vet shfrytëzimi i energjisë. Në rend të parë analizohen emisionet e përgjithshme nga vargu energjetik duke përfshirë: ndotjen e ujit, ajrit, tokës, menaxhimin e mbetjeve, zhurma dhe radioaktiviteti. Është me interes që të vlerësohen edhe aksidentet e mundshme që ndodhin gjatë procesit të prodhimit, transportit dhe shfrytëzimit të energjisë. Arritja e një baraspeshe në mes kërkesës për energji dhe ruajtjes së gjendjes së mjedisit është një sfidë e madhe. Duke zgjedhur llojet e burimeve të energjisë dhe teknologjive të përshtatshme zvogëlohet ndikimi në mjedis. P.sh nëse në vend të thëngjillit përdoret gazi natyror, atëherë emetimi i CO_2 zvogëlohet për 40%.



Furnizimi Total me Burime Primare Energjetike (ktoe)

Megjithatë, secili objekt energjetik në përmasa dhe forma të ndryshme ka ndikim në mjedis. Me ndërtimin e një hidrocentrali vije deri te çrregullimi i regjimit të ujërave nëntokësore dhe mikroklimës me ç'rast çrregullohet ekosistemi në hapësirën ku shtrihet objekti hidroenergjetik.

Prandaj konferenca nënvizoi veç tjerash edhe çështjet si n 137 vijim:

- Promovimi i shfrytëzimit të burimeve të ripërtritshme për prodhimin e energjisë elektrike;
- Promovimi dhe fuqizimi i efiçiencës energjetike;
- Evitimi i humbjeve te energjisë elektrike;
- Respektimi i kritereve dhe standardeve mjedisore në procesin e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike;
- Hartimi i programeve për reduktim të ndotjes;
- Respektimi i parimit mbi përdorimin e "teknologjisë më të mirë në dispozicion";
- Inspektimi dhe identifikimi i problemeve mjedisore të kapaciteteve ekzistuese prodhuese të energjisë elektrike;
- Përmirësimi i monitorimit të emisioneve në mjedis nga kapacitetet prodhuese energjetike ekzistuese.

Qeveritë komunale duhet të përgatiten – Nevojiten veprime në nivelin lokal

Ndryshimet dhe zhvillimet e viteve të fundit në sektorin e energjisë dhe në mbrojtjen e mjedisit, si në botë, rajon ashtu dhe në Kosovë, kanë ndikuar në çasjen e komunave ndaj këtyre temave. Duke qenë se komunat operojnë me një numër të madh të objekteve publike, si shkollat, qendrat e mjekësisë familjare, ndërtesat administrative, si dhe ndriçimin publik, ato kanë kushte të favorshme për mobilizimin dhe involvimin e qytetarëve dhe akterëve kyç siç janë shoqëria civile dhe OJQ-t.

Komunat janë përgjegjëse për edukimin fillor dhe të mesëm, kështu që mund të ndikojnë dukshëm në qëndrimin dhe mënyrën e sjelljes së qytetarëve, duke luajtur një rol aktiv në ngritjen e vetëdijes sa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe efiçiencës së energjisë. Ato gjithashtu mund të ndikojnë pozitivisht përmes opcioneve të planifikimit urban, transportit individual dhe publik, telekomunikacionit, menaxhimit të mbeturinave, furnizimit me ujë, si dhe përgjithësisht në mënyrën e harxhimit të energjisë.

Përfundimisht, planifikimi afatgjatë dhe ai afatmesëm në komuna duhet të shkojë krahas dhe t'i përgjigjet nevojës së ndryshimeve klimatike.

Mbrojtja e Mjedisit dhe Efiçienca e Energjisë

Ndër prioritetet të cilat duhet trajtuar në nivel kombëtar dhe sidomos në nivel lokal është kërkimi dhe gjetja e mundësive që ngrohja e shtëpive të mos bëhet duke shfrytëzuar energjinë elektrike, por të organizohet sistemi i ngrohjes me burim të përbashkët në mënyrë që të kursehet energjia elektrike, të ruhen resurset natyrore dhe të ruhet shëndeti.

Promovimi i efiçiencës së energjisë në fazën e ndërtimit të planeve urbane dhe zhvillimore lokale. Një model i mirë i planit parasheh ngritjen e efiçiencës në sistemin e transportit urban, në sistemet e furnizimit dhe ne politikat lokal të ndërtimeve.

Konferenca identifikoi se rol të rëndësishëm në këtë aspekt **ka komuniteti lokal.** Organizimi i programeve vullnetare për të reduktuar konsumin e energjisë si p.sh: fikja e dritave, zbritja e nivelit të termostatit, zëvendësimi i poçave etj. Por mënyra më efektive dhe e shpejtë për të rritur efiçiencën e energjisë reduktimin e gazrave serë dhe ruajtjen e shëndetit është nëpërmes ndryshimit të sjelljes personale dhe pjesëmarrjes në programe për ruajtjen e energjisë.

Punimet e konferencës janë orientuar duke marrë për bazë këto politika lokale, kombëtare, rajonale dhe globale siç janë:

- **Strategjia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit,** e cila në mesin e prioriteteve bazë ka edhe: *Zbatimi i konceptit të efikasitetit energjetik në të gjithë sektorët e shfrytëzimit të energjisë*.
- **Plan Kombëtarë për Veprim në Mjedis** në kuadër të të cilit është planifikuar realizimi i disa projekteve në lëmin e Efiçiencës së Energjisë
- **Strategjia e Energjisë e Kosovës,**
- **Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë në Kosovë 2006-2008,**
- **Programi i Kosovës për Efiçiencës të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë 2007-2009,**
- **Plani Komunal të Veprimit për zbatimin e programit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë 2008-2010,**
- **Traktati i Komunitetit të Energjisë.**







Përmbledhja e Prezantimeve

RIZA HAJADRI - Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
"Efiçienca e energjisë si masë preventive për mbrojtjen e mjedisit"

- *Efiçienca e Energjisë varësisht nga qasja mund të kuptohet si një koncept mjedisor, një koncept ekonomik, një koncept planifikimi dhe një koncept politik, që mund të ketë: efekte mjedisore, efekte energjetike por edhe efekte ekonomike.*
- *Efiçienca e Energjisë nuk është thjesht vetëm kursim i rrymës dhe i parasë, por më shumë se kaq është edhe mbrojtje e shëndetit dhe mjedisit.*
- *Çështje të cilave do te mundohemi t'i gjejmë përgjigje gjatë kësaj konference janë: A mundemi Ne: të ndërtojmë politika mbi EE, të organizojmë çmime stimuluese, të ndërtojmë kornizë të favorshme dhe stabile institucionale, të promovojmë PPP për të forcuar efektet e politikave publike, ti planifikojmë mire ligjet dhe rregulloret dhe ti bëjmë të jenë efektive.*
- *A mundemi ne të zbatojmë politika të EE të cilat adresojnë të gjitha fushat me potencial për kursimin e energjisë, të aplikojmë standarde për EE për të gjitha ndërtesat e reja, të koordinohemi në nivel regjional dhe me gjerë, të bëjmë evoluimin dhe monitorimin e masave të implementuara duke përdorur indikatorët, të aplikojmë një qasje të integruar të EE dhe të realizojmë masa të gjera për EE.*
- *Me një organizim të mirë institucional me orientim të drejte të investimeve publike dhe menaxhim efikas mundemi: të rregullojmë rrjetin e shpërndarjes së energjisë, të zbatojmë ngrohjen qendrore, të kursejmë energjinë në objektet publike, të përdorim burimet e riperterishme të energjisë.*

GABRIELE BECKER– GTZ
"Dialogu i strukturuar dhe këmbimi i njohurive"

- *Që të kemi një orientim më të qarte në implementimin e EE në nivelin lokal, fillimisht duhet të mundohemi të përgjigjemi në disa pyetje: Si do të ju përgjigjemi ndryshimeve të qarta që po ndodhin në natyrë? Si do ta përfytyrojmë të ardhëm? Si ta organizojmë një proces orientues strategjik aq të gjatë? Kush duhet të jetë në bord në mënyrë që procesi të jetë i suksesshëm? Si do të jetojmë në vitin 2030? Cili zhvillim është i parashikueshëm? Ku jemi duke shkuar? Si të fillojmë?*
- *Përgjigjeje për pyetjet e shtruara mundë të marrim duke orientuar drejtë objektivat e strategjisë energjetike të komunës, duke implementuar kritere për marrjen e vendimeve, duke inkurajuar politikat dhe aktivitetet e strategjisë komunale për energji si dhe duke i kyçur në këtë proces edhe qytetarët.*



SAMET DALIPI—Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal:
"Mjedisi dhe energjia në nivel lokal"

- *Në baze të rezultateve të pyetësorit për gjendjen e mjedisit dhe EE nëpër komuna del se: në komunat e Kosovës ka shumë pak debat për EE dhe Mbrojtjen e Mjedisit, ka shumë pak rregullore të miratuara për EE dhe mjedis, sikurse që ka shumë pak plane lokale të veprimit për EE dhe Mjedis.*
- *Të dhënat e pyetësorit flasin po ashtu se Komunat ballafaqohen me mungesë të ekspertëve për EE dhe mjedis, ka pak projekte të realizuara nga komuna dhe buxheti i Kosovës, ndërkohë që janë realizuar disa projekte nga organizatat e ndryshme donatore në këtë fushë.*
- *Sugjerohet që komunat duhet angazhuar ekspertë të fushave të energjisë dhe ambientit, të hartojnë plane apo së paku të iniciojnë projekte të cilat do të bashkfinancoheshin, të punojnë më aktivisht me qeverinë dhe donatorët për realizim të projekteve në fushën e energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit.*
- *Qeveria përmes ministrive përkatëse të orientohen drejt përkrahjes së komunave në ngritjen e kapaciteteve në lëmin e EE dhe mbrojtjen e mjedisit.*

Përmbledhja e Prezantimeve

SKENDER NITAJ– Ministria e Energjisë dhe Minierave
"Korniza ligjore dhe programore për Efiçiencës e Energjisë në Kosovë"

- ***Ligji Nr.2004/8 për Energjinë*** *në Kreun 3- rregullon çështjen e Efiçiencës së energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkë-prodhimin.*
- ***Strategjia e Energjisë së Kosovës 2005-2015,*** *në kuadër të masave dhe politikat për realizimin e objektivave strategjike parasheh: hartimin dhe miratimi i Ligjit për EE, hartimin e programit të Kosovës për EE dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë, themelimin e fondi për EE si dhe themelimin e Agjencionit të Kosovës për Efiçiencën e Energjisë.*
- *Në kuadër të* ***Programit për Zbatimin e SEK-ut 2006-2008****, është edhe nën-programi Efiçienca e Energjisë dhe Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.*
- ***Programi i Kosovës për EE dhe BRE 2007-2009****, parasheh disa projekte në sektorin e shërbimeve publike, sektorin banesor, industrinë, transportin dhe bujqësinë. Përveç zbatimit të projekteve teknike për EE, ky program parasheh edhe fushata edukimi, trajnimi dhe publikime të ndryshme.*
- *Në kuadër të projekteve të realizuara dhe të planifikuara duhet përmendur: Studimi i* ***Potencialit Hidroenergjetik*** *për Rajonet e ndryshme të Kosovës, Studimi i Parafizibilitetit për Identifikimin e Burimeve Ujore për Hidrocentrale të Vogla në Kosovë, kursin fillestar për Auditimin e Energjisë, Studimi për Vlerësimin e BRE në Kosovë dhe disa fushata vetëdijesimi.*
- *Kosova është pjesë e* ***Traktatit te Komunitetit të Energjisë****, i cili parasheh krijimin e një tregu të integruar për gazin natyror dhe energjinë elektrike për Evropën Juglindore. Kosova po ashtu ka qenë pjesëmarrëse e rregullt e takimeve të* ***Task Forcës për Efiçiencën e Energjisë.***





NASER RAMADANI—IKSHPK
"Kontributi i zbatimit të Efiçiencës së energjisë, në shëndetësinë publike"

- *Gjendja e mjedisit në masë të konsiderueshme ka ndikim edhe në shëndetin e popullatës. Nga prodhimi i energjisë së bazuar në resurse fosile rritet ndikimi në mjedis, por edhe në shëndetin publik. Nga mungesa e rrymës përveç stresit dhe traumave ka edhe ndikime tjera në shëndetin publik si rritjen e numrit të hospitalizimeve, rritjen e numrit të aksidenteve, rritjen e numrit të vetëvrasjeve, rritjen e sëmundjeve nervore dhe diareale.*
- *Shumë sëmundje janë rezultat i mungesës së ujit dhe sanitacionit, ndërsa është i ditur fakti se furnizimi i popullatës me ujë të pijes është i varur drejtpërdrejtë nga furnizimi me energji.*
- *Sipas të dhënave të IKSHPK vetëm 44% e popullatës në Kosovë është e kyçur në rrjetin publik të furnizimit me ujë, ndërsa vetëm 28% e popullatës është e kyçur në sistemin e kanalizimit. Rreth 64% e popullatës rurale në Kosovës përdorë ujin e bunarëve. Vlerësohet se 74%-90% e ujërave të bunarëve janë me kontaminimin fekal. 56% e të gjitha sëmundjeve ngjitëse i takojnë sindromit diareal, ku uji, ushqimi, sanitacioni dhe higjiena personale janë shkaktarë kryesorë.*
- *Gjatë viteve të fundit është shënuar rritje edhe e rasteve të kancerit. Edhe këto probleme të shëndetësisë publike janë të lidhura ngushtë me gjendjen e mjedisit dhe mënyrën e prodhimit të energjisë. Andaj duke zbatuar EE përveç mbrojtjes se mjedisit, mbrohet edhe shëndeti*

Përmbledhja e Prezantimeve

Dr. ZDRAVKO GENCEV - EnEffect

"Politikat lokale të Efiçiencës së Energjisë, te vendet anëtare të reja të Bashkimit Evropian-Bazuar në përvojën e Bullgarisë "

- *Për plotësimin e kornizës ligjore dhe institucionale për Efiçiencën e Energjisë, Kosova mund të përdor si model të përshtatshëm përvojën e Bullgarisë.*
- *Zbatimi i suksesshëm i EE lind edhe nevojat për aplikimin e reformave te autoriteteve lokale në politikave energjetike, instrumentet efektive të politikave, kapacitetin lokal te ndërtimit dhe në planin komunal për energji.*
- *Realizimi dhe demonstrimi i projekteve nëpër komuna, është po ashtu nevojë e domosdoshme për avancimin e çështjes së zbatimit të Efiçiencës së Energjisë.*
- *Demonstrimi i përkrahjes politike dhe lidhja e saj në instancat ndërkombëtare, bashkëpunim në mes të shteteve të Evropës Juglindore, është edhe një faktor tjetër i rëndësishëm për implementimin e suksesshëm të Efiçiencës së Energjisë.*
- *Zhvillimi dhe implementimi i programeve të ndryshme është domosdoshmëri e suksesit të zbatimit të EE.*



FAHRI BLAKAJ—Ministria e Energjisë dhe Minierave

"Ndërtimi dhe fuqizimi institucional i Sektorit të Efiçiencës së Energjisë, në Kosovë"

- *Sektori i Efiçiencës së Energjisë, në kuadër të strukturës organizative institucionale të MEM është i organizuar në nivel divizioni, ku EE është bashkë-sektor me Burimet e Ripertritshme të Energjisë dhe Mjedisin, në kuadër të Departamentit të Energjisë.*
- *Kuadri ligjor e rregullator i EE- trajtohet nga një kornizë solide ligjore e rregullatore ku bëjnë pjesë: Ligji Nr.2004/8 për Energjinë, Legjislacioni sekondar, Strategjia e Energjisë së Kosovës, Programi trevjeçar për Zbatimin e SEK -ut dhe Programi trevjeçar i Kosovës për EE dhe BRE.*
- *Programi i Efiçiencës së energjisë- mbështetet në Programin për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë (2006-2008) dhe përfshinë 18 projekte nga gjashtë sektorët ku duhet të zbatohen masat e EE.*
- *Deri tash janë zbatuar ose janë në zbatim e sipër projektet e përfshira në këtë program. Në zbatim të legjislacionit ekzistues sekondar për EE janë ndërmarrë disa aktivitete siç janë: organizimi i kursit fillestar për auditimin e energjisë, ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e energjisë në nivel komunal, promovimi i shfrytëzimit të energjisë solare dhe studimi i potencialeve të BRE.*
- *Për të avancuar më tutje çështjen e EE rekomandohet të fuqizohet sektori i EE, të ndërtohet mekanizmi i specializuar për zbatimin e politikave të EE, si dhe të themelohet Fondi për EE, BRE dhe Mjedis.*

Përmbledhja e Prezantimeve

Dr. FRANK RIESBECK– Universiteti i Humbolltit, Berlin

- *Të shumta janë arsyet për të zbatuar ndryshime në mënyrën e prodhimit të energjisë, shfrytëzimin e resurseve energjetike dhe shfrytëzimin me efikasitet të energjisë.*
- *Mbrojtja e mjedisit, ulja e ndotjes së ajrit dhe ujit, duke aplikuar EE dhe duke shfrytëzuar burimet e ripërtrishme të Energjisë është vetëm një prej tyre.*
- *Shembuj praktik për mundësit alternative të prodhimit të energjisë, janë: përdorimi i mbeturinave si burim për energji, shfrytëzimi i energjisë solare, shfrytëzimi i energjisë së erës, asaj gjeotermike dhe të ujit.*
- *Trajtimi mekanikë-biologjik i mbeturinave të amvisërisë, trajtimi i mbeturinave organike, trajtimi i biogasit në kombinim me produktet bujqësore, mbeturinat plastike dhe riciklimi i produkteve të naftës., janë disa prej pilot projekteve që mund të aplikohen nëpër komunat e Kosovës.*

LIULIN RADULOV - Fondi i Bullgarisë për Efiçiencë të Energjisë

"Financimi i Efiçiencës së Energjisë, projektet investive dhe para financimi i programeve operative te

- *Për implementimit e suksesshëm të EE nevojiten edhe mjetet financiare. Një prej formave të sigurimit të këtyre mjeteve është themelimi i fondit për EE. Përvoja e Bullgarisë në themelimin dhe funksionalizimin e këtij fondi është një model i mirë.*
- *Përcaktimi i drejtë i objektivave të fondin, principet e operimit, pozicioni i tregut, kushtet financiare, kriteret e zgjedhjes dhe llojet e projekteve janë disa nga parakushtet e nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e Fondit për Efiçiencë të Energjisë*
- *Shtrirja e fondit nëpër komuna, zbatimi i programeve operuese të Bashkimit Evropian, demonstrimi i projekteve për renovimin e ndërtesave të komunave, pikat orientuese të portofolit të Guarantees, mënyra e aplikimit në bankat komercial, aplikimi i ESCO dhe implementimi i projekteve nga këto programe janë po ashtu të domosdoshme.*

MALIQ PIRECI - AKEREE

- *Kursimi i energjisë si dhe shfrytëzimi sa më efiçient i saj, ndikon në uljen e konsumit specifik, në furnizim të rregullt dhe cilësor të konsumatorëve, uljen e kostos dhe shërbimeve vendore, përmirësimin e ndjeshëm të bilancit energjetik, përmirësimin e sigurisë kombëtare të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit.*
- *AKEREE ka realizuar disa projekte ku janë hulumtuar mundësitë e kursimit të energjisë dhe shfrytëzimit me efiçient të saj.*
- *Projektet e realizuara kanë treguar se mundësitë e kursimit të energjisë dhe shfrytëzimi me efiçiencë i saj, janë shume reale dhe mundë të zbatohen me pak investime, ndërsa rezultatet e tyre janë shume të leverdishme si në aspektin e kursimit të energjisë ashtu edhe në kursimin e mjeteve financiare.*
- *Duke u nisur nga rezultatet e këtyre hulumtimeve, rekomandohet zbatimi i disa masave si:*
- *Vendosja e sistemit qendror të komandimit për ndriçimin publik dhe përcaktimi i orarit kohor/ intensitetit të ndriçimit në rrugë të caktuara,*
- *Përshtatja e distancës në mes trupave ndriçues dhe lartësia e trupave ndriçues dhe përdorimi i trupave ndriçues efiçient,*
- *Izolimi termik i ndërtesave, përdorimi i dritareve/dyerve termoizoluese dhe aplikimi i ngrohjes qendrore,*
- *Vendosja e valvuleve me kokë termostati në hyrje të radiatorëve dhe përdorimi i kaldajave efiçiente për ngrohje qendrore,*
- *Aplikimi i ngrohjes kolektive të ndërtesave, dhe vendosjen e kalorimatësve për secilën banesë,*
- *Përdorimin e pajisjeve elektro-shtëpiake efiçiente,*
- *Përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në ngrohjen e ujit sanitar,*
- *Aplikimin e Kodit Energjetik të Ndërtesave (KEN) etj.*

Rezultatet e grupeve punuese

Sesioni tematik A - *Veprimet dhe mekanizmat implementues*

Grupi I- Korniza Ligjore

- Procedimi i serishëm i projekt-ligjit për efiçiencë të energjisë;
- Kompletimi i legjislacionit sekondar për efiçiencë të energjisë dhe burime të ripëtritshme të energjisë;
- Komunat të nxjerrin rregulloret në bazë të kompetencave, për zbatim të Udhëzimeve Administrative për efiçiencë të energjisë dhe mjedis;
- Decentralizimi i kompetencave në nivel lokal, për efiçiencë të energjisë dhe mjedis;
- Pjesëmarrja e zyrtarëve komunal në grupet punuese qysh me nismën e hartimit të ligjeve në nivelin ministror

Grupi II- Korniza Institucionale

- Ngritja e zyrave komunale për energji;
- Themelimi i Agjencisë së Kosovës për efiçiencë të energjisë;
- Ngritja dhe fuqizimi i auditorëve të energjisë si dhe licencimi i tyre;
- Krijimi i gjeo-databazës për efiçiencë të energjisë dhe burime të ripëtritshme të energjisë,
- Të koordinohen aktivitetet rreth efiçiencës së energjisë në mes institucioneve qendrore (MEM, MMPH, AKMM, MAPL), institucioneve lokale (komunat) dhe OJQ-ve.

Grupi III- Financat dhe masat stimuluese

- Masa lehtësuese për bizneset – investitorët në efiçiencë të energjisë dhe burime të ripëtritshme të energjisë, në nivel lokal dhe qendror;
- Themelimi i Fondit për efiçiencë të energjisë dhe burime të ripëtritshme të energjisë, ;
- Komunat t'u japin prioritet projekteve për efiçiencë të energjisë, me bashkëfinancim;
- Ofrimi i kredive të buta për projekte të efiçiencë te energjisë;
- Decentralizim financiar për projekte kapitale në nivel lokal.



Rezultatet e grupeve punuese

Sesioni tematik B– *Praktikat, Mundësitë*

Grupi I- Projektet për ngritjen e kapaciteteve



- Themelimi i Rrjetit Nacional për EE si organ i pavarur institucional, OJQ;
- Projekte për ngritjen profesionale të kapaciteteve nëpër komuna;
- Trajnimi i trajnerëve për EE;
- Trajnimi i zyrtarëve të komunave për EE;
- Ngritja (themelimi) i qendrës për trajnime për Mjedis dhe EE;
- Bashkëpunimi regjional për këmbim të përvojave për EE dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Organizimi i vizitave studimore për zyrtarët e komunave; zyrtarë të institucioneve qendrore, OJQ dhe akterët tjerë.

Grupi II- Projektet për vetëdijesim dhe sensibilizim

- Finalizimi i paketës së gjelbër dhe implementimi i saj në institucionet edukative publike;
- Edukimi dhe vetëdijesimi mjedisor dhe për Efiçiencën të energjisë jashtë sistemit publik;
- Forcimi i Sektorit të ministrive që kanë të bëjnë me fushatën dhe vetëdijesim;
- Publikimi i revistës mjedisore dhe EE;
- Organizimi i debateve publike me qytetaret duke përfshirë OJQ-të;
- Involvimi më i madh i mediave;
- Përfshirja në universitet dhe në plan-programet shkollore e lendes për EE;
- Telefoni i gjelbër.

Grupi III- Projektet konkrete teknike

- Studime, hulumtime për potencialet alternative për përfitime të energjisë (ujit, erës, biomasës, solare, mbeturinave dhe gjeo-thermale) me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave për potencialet e energjisë alternative;
- Promovim të zvogëlimit të konsumit të energjisë reaktive në industri dhe distribuim,
- Trajtimi biomekanik i mbeturinave bazuar në modelin PPP (partneriteti publiko-privat);
- Përdorimi i kamerës termo-grafike për objekte publike (pilot projekte);
- Forcimi i sistemit të monitorimit të mjedisit;
- Organizimi i konferencës për teknologji të EE;
- Hartimi i Planit për zbatimin e masave të EE në sektorin e transportit, industrisë dhe bujqësisë;
- Vazhdimi i projektit për ngrohje të qytetit të Prishtinës nga termocentralet;
- Instalimi i ngrohjeve qendrore me teknologji solare dhe gjeotermale;
- Ndriçimi publik i qytetit me panela P.V. (foto voltaik) për Shtime (pilot projekt)
- Zbatimi i ndriçimit efiçient;
- Përdorimi i paneleve diellore për ngrohje të ujit sanitar në objekte publike (spitale, çerdhe, kazerma, konvikte, halla sportive, objekte të banimit social).



Organizatorët, partnerët dhe sponzorët

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
Ministria e Energjisë dhe Minierave
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministria e Shëndetësisë

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës

Asociacioni i Komunave të Kosovës

gtz Partner for the Future Worldwide
On behalf of Federal Ministry for Economic Cooperation and Development

ProCredit Bank

STRABAG

Përgatiti dhe dizajnoi: A. Berisha